

Dalës-izlezn:

Nr. 1-19 Data 16.02.2023  
Br. Datum

OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVË  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.01.2023, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrdhënie me publikun e tjerë

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale 2023-2027
4. Shqyrtimi i Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave
5. Raporti vjetor i punës i Kuvendit komunal
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, dhe propozoi që në pikën 5 të rendit të ditës të futet shqyrtimi i propozim vendimit të planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2023. Miratohet rendi i ditës me 6 vota për me ndryshimin dhe plotësimin e cekur më lartë.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e Draft Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale 2023-2027.

**Enver Gashi** – Ne jemi për dhënien në debat publik të këtij Draft plani.

**Sami Ahmeti** – Ede ne jemi për atë që të bisedohet në seancën e ardhshme.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e Draft Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale 2023-2027.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave. Është një Rregullore e cila që 2 herë po kthehet në rishqyrtim nga Ministria e financave dhe unë kërkova nga Komisioni të na sqarojnë se cili është problemi dhe mundësisht të bëjmë ndryshimin që mos të kthehet më kjo Rregullore.

**Enver Gashi** - Është për keqardhje hera e tretë me u kthye kjo Rregullore, që vërtetë ose ne nuk jemi në rregullë, ose ata të Ministrisë nuk po dijnë as vetë çka po kërkojnë. Është mirë që kjo Rregullore të shqyrtohet në Kuvend, të vjen edhe Komisioni ose Drejtoria e financave dhe të na shpjegon se çka duhet të veprojme. Nëse, Drejtoria nuk ka kontaktue me Ministrinë, le të kontaktojnë se çka po dojnë ata dhe ta rregullojmë këtë çështje.

**Sami Ahmeti** – Ne kur patëm takim për me draftue planin e punës së Kuvendit dhe biseduam, aty ishte një përgjegje që ka të bëjë për çështjen financiare për me bë një përshkrim të saj. Unë nuk dua ta mbështesë këtu as punën e atyre, por dua të dalim ne si Kuvend shumë mirë. Vërtetë, është një vërejtje që edhe unë pajtohem se Komisioni është mirë të shkoj atje dhe të konsultohet me udhëheqësit ligjor. Ishte vetëm një nen i Rregullores, që mendoj se është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Obiliqit, për ato kategori që kanë nevoja të shumta. Konsideroj se duhet gjithsesi me bisedue në seancën e ardhshme, por para kësaj do të ishte mirë që Komisioni të ketë takim me Ministrinë dhe të dijmë se çka po dojnë, ose si mund të riformulohet ai nen, në mënyrë që mos me ra më ndesh sepse është një prej Rregulloreve që vërtetë qytetarët kanë nevojë në raste emergjente kur po ndodhin vdekjet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti Propozim Vendimin nr.-I-08, të dt.19.01.2023, për aprovimin e Planit të punës së Kuvendit komunal Obiliq, për vitin 2023.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që ky propozim vendim ti rekomandohet Kuvendit komunal dhe aty ne do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** – Është një plan standard që duhet ta ketë Kuvendi komunal dhe ne jemi munduar sa kemi mund me dhënë kontributin tonë, megjithatë punën më të madhe e ka bë kryesuesja dhe shfrytëzoj rastin me falenderue, kështu që edhe ne jemi për që ky plan të shkoj në seancën e radhës të Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal Propozim Vendimin nr.-I-08, të dt.19.01.2023, për aprovimin e Planit të punës së Kuvendit komunal Obiliq, për vitin 2023.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti raportin vjetor të punës së Kuvendit komunal Janar-Dhjetor 2022.

**Enver Gashi** – Unë edhe atë ditë e falënderova Kuvendin dhe tash i dëshiroj një punë më të mirë se atë që e kemi kalue, sigurisht se kemi mundësi dhe kapacitete.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi dakord që ky raport të shkoj në seancë dhe atje mund të përballemi me numrat që i keni dhënë në raport megjithatë, pa keqkuptime për shkak se janë 6 Rregullore që janë kthye, por janë edhe shumë Rregullore tjera, që janë kthye pjesërisht, do të thotë është dashtë me i ripërpunue te nenet e caktuara. Gjithsesi, se jemi për atë që të bisedojmë në seancën e ardhshme të Kuvendit komunal.

**Kryesuesja** – Ka edhe të tjera, që kanë ardhë pjesërisht, por sipas raportit që e kemi dërgue në MAPL, ata kanë kërkuar vetëm ato që janë të shfuqizuara

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal Raportin e punës të Kuvendit komunal Janar-Dhjetor 2022.

### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Këshilli i Bashkësisë Islame, që xhamitë brenda territorit të Komunës, që figurojnë në prona komunale të bëhet bartja e tyre në emër të institucionit fetar. Unë propozoj që kjo kërkesë ti adresohet DPUKP-së, nëse, edhe ju jeni të pajtimit dhe Drejtoria të vjen me një rekomandim.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo kërkesë të shkoj në DPUKP dhe kam thënë se të gjitha kërkesat duhet të shkojnë nëpër Drejtori, e sidomos te pronat duhet të kemi më shumë kujdes, prandaj Drejtoria duhet të vjen me një rekomandim në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan DPUKP-së, shqyrtimin e kërkesës nga Këshilli i Bashkësisë Islame nr.-I-409/2023, të dt.06.01.2023, që xhamitë brenda territorit të Komunës së Obiliqit, të cilat gjenden dhe figurojnë në prona komunale të mundësohet bartja e tyre në emër të institucionit fetar Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës - Këshillit të Bashkësisë Islame në Obiliq.

DPUKP-ja, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë duhet të vjen me një rekomandim në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Realisht është mirë kërkesat para se të na vijnë neve, me i pasë edhe rekomandimet e Drejtorive. Gjithsesi, është nonsens me na ardhë diçka që ne nuk e dijmë bazën ligjore qysh shkojnë procedurat e bartjes së një prone prej një subjekti në një subjekt tjetër dhe aq më tepër në kërkesën e pranuar e ka cekë zotëriu se është urgjente, por pse është urgjente nuk e dijmë. Le të mbetet në përgjegjësinë e Drejtorisë që në seancën e ardhshme, kërkesat të cilat po na vijnë normal që ne nuk jemi subjekti që i trajtojmë dhe ua zgjedhim çështjen, por pasi neve na u ka drejtue edhe ne me pasë një përgjegje nga Drejtoria gjegjëse që me ditë se çka u bë me këtë kërkesë. Gjithsesi, është përgjegjësi e Drejtorisë dhe unë jam dakord që ti shkoj Drejtorisë, por Drejtoria të merrë mundin dhe të na informoj se si është kjo procedurë ndoshta, mësojmë edhe ne diçka prej tyre.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Murat Mustafa, nga qytetarët e lagjes nën hekurudhë për një nënkalim që të lidhen me qytetin pasi që ndërtimi i hekurudhës paraqet rrezik për ata qytetarë.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që së pari kjo kërkesë të shkon në Drejtori, pastaj të vjen në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi për këtë procedurë edhe pse ajo zonë vërtetë kanë nevojë për një çështje të tillë. Ka metoda të ndryshme që bëhen edhe jashtë sepse nuk bllokohet për shkak të një hekurudhe një lagje ose një zonë e caktuar. Vërtetë, ajo zonë ka nevojë për një nënkalim, ose të paktën me u vendosë rampat me që me pasë një mundësi të tillë. Mirëpo, sido që ta bëjnë këto, verzione Drejtoria mundet me na i ofrujë të cilat janë të mundshme dhe jemi për atë që këtë kërkesë me trajtue sepse vërtetë, është një prej problemeve që e kanë ata qytetarë.

**Labinot Mirena** – Pajtohem plotësisht me kërkesën që e kanë dorëzue, por nuk e di kryesuese a ka ardhë edhe një kërkesë tjetër që është prej lagjes Grajqevci, do të thotë ata janë nën hekurudhë. Besoj se këtyre ditëve e kanë dorëzue, por sigurisht ende nuk ka ardhë prej administratës atje. Është jashtëzakonisht e nevojshme dhe tash pritet edhe ndërtimi i lartë. Nëse, tash janë psh 20 nxënës që e kalojnë hekurudhën në të ardhmen e afërt do të jenë 100, kështu që nënkalimi për atë pjesën andej është i domosdoshëm.

**Kryesuesja** – Jo, nuk e kam marrë atë kërkesë, por këtë e paraqita me shqyrtue nëse jeni të pajtimit sepse ka ardhë me vonesë dhe me lënë deri në muajin tjetër bëhet pak vonë. Nëse, vjen ajo kërkesë nëse ju pajtoheni me ia adresue Drejtorisë që të 2 këto, kërkesa dhe në mbledhjen e Kuvendit të na sqarojnë çështjen.

**Enver Gashi** – Mendoj se nënkalimi kishte me qenë ndoshta më i përshtatshëm sepse është një element që duhet patjetër atyre banorëve me ju dalë në ndihmë. Pasi që është në fazën e rindërtimit është më lehtë edhe për hekurudhën edhe për neve si Komunë, që me gjetë një modus dhe me përfundue këtë çështje që është shumë me rëndësi për të gjithë ata banorë që janë matanë hekurudhës.

**Sami Ahmeti** - Pikërisht, është kjo pak urgjente që vërtetë me u trajtue në seancën e ardhshme në mënyrë që ta dijmë se qysh është gjendja. Nëse ka nevojë dhe ka mundësi qoftë me u interesue edhe në Ministri, me u krijuë edhe një Komision me qenë e nevojshme prej Kuvendit komunal dhe me shkue edhe në Ministrinë gjegjëse që vërtetë këtë çështje me shtye. Pasi që tash është duke u punuar i kanë heqë komplet shinat, bazamentin e tyre, është mundësia shumë e madhe me lidhë atë lagje dhe me zgjidhë këtë problem,

që unë të paktën qe 5,6 vjet që jam kësajde nga Obiliqi, cilin banorë të asaj ane që e takoj e ka këtë hall që po i bëhet prej halleve kryesore. Mundësisht le te marrin pak si me urgjencë, pasi që veç është duke u punue që mos me thënë pastaj, nuk e kemi parë këtë kërkesë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan DSHPE-së, shqyrtimin e kërkesës nr.-I-1714/2023, të dt.18.01.2023, nga Murat Mustafa, për ndërtimin e një nënkalimi nën hekurudhë për kalim të sigurtë të kembësorëve dhe automjeteve.

DSHPE-ja, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë duhet të vjen me një rekomandim në Kuvend.

**Kryesuesja** – E kemi një kërkesë tjetër nga z.Fidan Ahmeti për kompensim të aksionarëve për çdo muaj në KRM “Pastrimi”. Pra, anëtari i Kuvendit ka kërkuar që vendimi i mëhershëm të ndryshohet dhe plotësohet me pikën se duhet aksionarët të paguhen dhe mjetet duhet të merren nga vetë kompania.

**Enver Gashi** – Ne jemi për që ti rekomandohet kjo kërkesë Kuvendit komunal, por duhet të shqyrtohet ligji se a kemi të drejtë dhe sa është shuma e mjeteve. Po ashtu, duhet shikuar edhe kompanitë tjera, si kanë veprue, pastaj edhe ne të veprojmë.

**Labinot Mirena** – Unë sa di që jam pjesë e kompanisë “Pastrimi” nuk paguhem aksionarët as të Obiliqit, as të Fushë Kosovës, as të Podujevës dhe as të Lipjanit. Nëse, kompania ka marrë ndonë vendim përmes Bordit nuk e di, por sa e di unë nuk paguhem sepse nuk paguhem as aksionarët që janë të kompanisë publike në Obiliq NPL “Kastrioti”. Meqë, nuk jam i informuar dhe nuk di qysh me marrë ne vendim psh që nuk varet kjo punë hiç prej neve.

**Kryesuesja** – Kuvendi i Prishtinës e ka ndryshue vendimin siç e kemi marrë edhe ne të aksionarëve më parë për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve dhe e ka obligue Ndërmarrjen ti paguaj aksionarët. Mendoj se ne duhet të konsultohemi me zyrtaren ligjore për këtë çështje.

**Sami Ahmeti** – Kur emërohen prej Kuvendit anëtarët e Komisioneve, besoj se edhe ne e kemi një përgjegjësi të paktën me i ditë se qysh janë procedurat. Unë nuk jam për atë që me shkue dikush me shërbye sepse tërë koha është e vlefshme për secilin. Ne me shkue me shërbye dihet se jemi të zgjedhur prej qytetarëve dhe atë punë e kemi marrë, por edhe kompensimet duhet me u paraparë siç thanë edhe parafolësit se ne nuk mund të marrim në formën se po dojmë me i dhënë dikujt diçka sepse nuk e kemi atë kompetencë. Pasi e kemi kompetencën me i zgjedhë ata aksionarë, ne kemi të drejtë me kërkuë se cila është baza ligjore që me u kompensue psh e kemi rastin te Komisioni për Këshilla të fshatrave. Tash, pa marrë parasysh që unë nuk kam qenë, por kanë qenë disa që kanë shkue nëpër të gjitha fshatrat, disa kanë shkue edhe me vutura të veta dhe në fund mos me u kompensue fare, unë mendoj se nuk është në rregullë.

Është mirë të merret baza ligjore dhe ai Komision me u kompensue. Ne e dijmë se është në ligj që në Komisionet obligative të paguhen veç njëri prej këtyre Komisioneve, por mendoj se nuk është në rregullë se Komuna, institucionet kanë me shfletue shumë dhe me pa bazën ligjore. Unë jam për atë që zyra ligjore të merret me këtë çështje, Drejtoritë të cilat i mbulojnë këto, me ardhë dhe me na tregue bazën ligjore, pse mos me pyet edhe Komunën e Prishtinës, se cila është baza ligjore sepse aty, nuk po shkruan cili ligj, cili nen.

**Kryesuesja** – Ne do të kërkojmë që kjo çështje të debatohet në Kuvend, sepse kemi mjaft Komisione prej Kuvendit komunal që nuk është duke iu bërë pagesa dhe nëse, një Komunë e bën pagesën e tillë atëherë pse edhe Komuna jonë të mos e bëjë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim kërkesën nga z.Fidan Ahmeti, për kompenzim të aksionarëve, sipas vendimit nr.-I-94, të dt.29.06.2022.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** – Kryesuese, një kërkesë gjatë punës tonë e bëre që më bëri edhe mua me qenë dakord, ishte kërkesa që mbledhjen e KPF-së, me fillue mundësisht prej orës 11. Kjo ishte kërkesa më shumë për ty kryesuese sepse ishe e zënë me nxënës, ose parashkollorë me të cilët merreni ju. Sa na përket neve, ne kemi biseduar me znj.Ajshe, nëse doni me bisedue neve nuk na prishë punë që mbledhja e KPF-së, të filloj në ora 10 ose 11 dhe këtë e bëjmë për juve si kryesuese sepse kemi nevojë për juve dhe nxënësit kanë nevojë me pasë mbështetjen e juaj gjatë orarit, kështu na shpjegove.



**Kryesuesja** – Sqaron se është kërkesa ime personale mundësisht që mbledhjet e KPF-së, ti mbajmë në ora 11. Unë jam me nxënës deri në orën 10:30' dhe po më bjen 2 herë në muaj me i lënë fëmijët. Edhe mësuesja nuk po i njehë prindërit bash në kohën kur po dorëzohen te prindërit dhe ka ndodhë që një fëmijë ka ikë dhe vetë ka shkue në shtëpi, çka nëse atë fëmijë kishte me shkelë vetura apo diçka tjetër. Pra, nëse, juve nuk ju prish punë që KPF-ja në të ardhmen të mbahet në ora 11.

**Labinot Mirena** – Jo, nuk prish punë kryesuese, por ne kemi kërkesë edhe për mbledhje të Kuvendit sepse kemi mjaft punëtorë të KEK-ut, të cilët nuk mund të vijnë në ora 10 në mbledhje. Është mirë që mbledhja e Kuvendit komunal të filloj në ora 11 për shkak të këtyre punëtorëve.

**Kryesuesja** - Unë do ta kontaktoj MAPL-në, nëse atyre nuk ju paraqetë telashe që ne mbledhjen me fillue prej orës 11.

**Sami Ahmeti** – Më duket z.Shaip Paloja, e ka bërë këtë kërkesë dhe gjithsesi neve nuk na prish punë një orë më heret, ose më vonë, por te këto unë dyshoj se mbledhjet e Kuvendit komunal monitorohen live dhe mund të jetë që MAPL-ja, nuk na lejon. Mirëpo, për neve si grup kjo nuk prish punë sikurse te kërkesa juaj sikurse e këtyre të cilët janë të angazhuar.

**Kryesuesja** – Atëherë, për KPF-në, u dakordua që mbledhjen ta fillojmë prej orës 11 ndërsa, sa i përket mbledhjes së Kuvendit, do ta kontaktoj Ministrinë nëse, nuk ka ndonjë pengesë që mbledhjet ti mbajmë prej orës 11 dhe e sqarojmë në mbledhjen e radhës këtë çështje.

**Sami Ahmeti** - Unë i kam 2 kërkesa për seancën e ardhshme dhe e para është kam pasë kërkesa prej disa mësimdhënësve që kanë dashtë të mbeten anonim, me trajtue çështjen e materialit administrativ nëpër shkolla. Është çështja kryesore letër e formatit A 4 mungon nëpër shkolla, ka munguar vazhdimisht në masë të mjaftueshme. Mirëpo, tash unë kam pasë ankesa se arsimtarët në kohën e testeve po iu bjen me ble letër prej vetes dhe me i përgatitë testet dhe në shumë shkolla po kanë problem edhe me i fotokopjue ato. Ne kishim pasë dëshirë që në seancën e ardhshme me na informue dhe me pa se ku është pengesa, a kemi mundësi ne si Kuvend me ndihmue në këtë drejtim sepse vërtetë është e pakuptueshme që mësimdhënësit për teste me ble letër vetë. Mund edhe të mos jetë komplet kështu sepse nuk i kam konfirmuar këto informata, por pasi që është Drejtoria përgjegjëse për këtë punë le të na jepë një përgjegje se a është kështu, apo nuk është. Nën 2, kisha kërkuar ky Kuvend në vitin e kaluar ka miratuar një ndihmë për paragllajtin dhe pak më vonë është shfuqizuar kjo, ato mjete të dedikuara për atë fushë kishim pasë dëshirë me ditë se ku janë ridestinue, sigurisht nga Drejtoria e financave.

**Kryesuesja** – Sqaron se mjetet nuk janë ndarë për kërkesën e paragllajtit. Kërkesa është e njejtë për FC “KEK”-un dhe pasi që është aprovue kërkesa, pasi ka ardhë ligjshmëria nga Ministria, atëherë Ekzekutivi me bartje të mjeteve dhe rishqyrtim të buxhetit i ka ndarë mjetet, e jo para se ne me marrë vendim. Unë gjithsesi kërkesën tuaj do ta adresoj në DEFZH.

**Lindita Bektashi** - Është e vërtetë se kemi probleme me material administrativ, por problemi kryesor është te AQP-ja, për shkak se kontrata është e lidhur përmes AQP-së dhe AQP-ja, kështu na ka lënë deri para një jave, nuk ka lidhë kontratë dhe para një jave ka lidhë kontratë për material administrativ. Po ashtu, varet rrjedhja e parasë mundet me vazhdue deri në shkurt dhe mars, kështu që nuk po na lejon me marrë material administrativ, prandaj nuk është faji ynë. Ne si Komunë kemi mjaft mungesë të materialit administrativ, por shpresoj se shumë shpejtë do të zgjidhet ky problem. Z.Ahmeti, e përmendi edhe Komisionin e Këshillave të fshatrave, që pajtohem plotësisht se Komisioni e ka bërë një punë të jashtëzakonshme dhe duhet të paguhet. Arsyeja pse nuk e kam sjellë në Kuvend ka qenë me u konsultue me zyren ligjore, ose me Komunit tjera se qysh kanë veprue në këtë rast, kështu që në seancën e ardhshme do ta paraqesë në Kuvend sepse pagesën e kishin bërë përmes Kuvendit.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:42'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesja e KPF**  
  
Vlora Mjekiqi Kabashi

